

Plani i veprimit për Konsolidimin e Tokës 2010 – 2020

Drafti final i Grupit Punues

Prishtinë 2010

Shkurtesat dhe termet

UA	:	Udhëzimet Administrative
ZK	:	Zona Kadastrale
ECLO	:	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
QeK	:	Qeveria e Kosovës
RDPP	:	Regjistri i të Drejtës në Pronë të Paluajtshme
AKK	:	Agjencioni Kadastral i Kosovës
KT	:	Konsolidimi i Tokave (=Rregullimi i Tokave)
KKRT	:	Komisioni Komunal për Rregullimin e Tokave
ZKT	:	Zyra për Rregullimin e Tokave
RT	:	Rregullimi i Tokave (në anglisht: = konsolidimi i tokave)
LpTB	:	Ligji për Tokë Bujqësore
LpKT	:	Ligji për Konsolidimin e Tokave (1987)
LpRT	:	Ligji për Rregullimin e Tokave (draft)
MBPZHR	:	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
ZKK	;;	Zyra Kadastrale Komunale
MMPH	:	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
RVT	:	Rregullimi vullnetar i tokave
Strategjia	:	Strategjia për Konsolidim të Tokave 2010-2012
RPT	:	Rregullimi i papërfunduar i tokave

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Sfondi
3. Konsolidimet e papërfunduara të tokave
4. Konsolidimet vullnetare të tokave
5. Kushtet që duhet plotësuar
6. Buxhetimi

SHTOJCA 1:	Lista e Zonave kadastrale me Konsolidime të Papërfunduara të Tokave dhe Statusi i tyre në Korrik 2010
SHTOJCA 2:	Ndarja e Punëve në Faza dhe Buxhetimi i Konsolidimeve të Papërfunduara të Tokave
SHTOJCA 3:	Përmbledhja e aktiviteteve dhe detyrave të Akterëve në Konsolidimet vullnetare të Tokave.
SHTOJCA 4:	Përmbledhja e aktiviteteve dhe detyrave të Akterëve në Konsolidimet te pa përfunduar të Tokave. (MBPZHR, Mars, 2009)

1. HYRJE

Ky Plan Veprim është përgatitur me qëllim të implementimit të Strategjisë për Konsolidimin e Tokës 2010-2012, më tutje i referohemi si Strategjia. Baza e Strategjisë është përgatitur në kuadër të projektit për Shfrytëzimin e Tokave Bujqësore (ALUP, 2006-2008), projekt i mbështetur nga AER-i) dhe më tutje i zhvilluar në vitin 2009-2010 nga Grupi Punues (Ref.SP-545/09, i datës 1 Shtator 2009) i cili është përgjegjës për shqyrtimin dhe plotësimin e Strategjisë. Këtij Grupi Punues më tutje i referohemi si Grupi Punues për Strategji. Strategjia ka përmbushur tani të gjitha procedurat e nevojshme të shqyrtimit, përfshirë dorëzimin tek Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO) për komente. Plani i Veprimit së bashku me buxhetin e paraparë për implementim i kanë kaluar të gjitha procedurat e nevojshme për miratim.

Plan-Veprimi përfshin një periudhë 10 vjeçare, njëjtë si periudha kohore e Strategjisë. Është paraparë që gjatë kësaj periudhe të zgjidhet problemi i Konsolidimit të Papërfunduar të Tokave. Në këtë 10 vjetësh, pritët që të krijohet koncepti i Konsolidimit Vullnetar të Tokave si opsion i vlefshëm për ata fermerë të cilët synojnë të përmirësojnë strukturën e ekonomive të tyre shtëpiake, të përmirësojnë qëndrueshmërinë e fermave të tyre dhe në këtë mënyrë të përmirësojnë kushtet e jetesës. Përveç kësaj, mund të krijohen lloje tjera të rregullimeve të tokave, të përmendura në Strategji.

Në këtë Plan Veprim, është shfrytëzuar puna e mëhershme e ALUP-it dhe MBPZHR. Pastaj, është bërë shfrytëzim i gjerë i ekspertizës së të gjitha Zyrave Kadastrale në Komunë, AKK-së dhe përvojave tjera të aktorëve tjerë vendimtar, qoftë të kompanive implementuese dhe mbikëqyrëse të angazhuara në realizimin e projekteve të konsolidimit të tokës.

1. SFONDI

Në Kosovë ekonomitë shtëpiake bujqësore janë të shpërndara, të vogla dhe bazohen në prodhimtarinë ekzistenciale. Politika e Qeverisë së Kosovës (QeK) ka për qëllim krijimin e bujqësisë familjare komerciale dhe ekonomikisht të qëndrueshme. Rregullimi i tokave është mjet i dobishëm dhe efektiv për të shkuar në këtë drejtim.

Edhe pse Strategjia njeh 5 lloje të rregullimit të tokave, aktualisht në Kosovë ekzistojnë dy lloje.

Konsolidimet e papërfunduara të tokave (KPT). Konsolidimet e tokave të kryera në mes të vitit 1983 dhe 1989, por mbetën të pakryera në faza të ndryshme të mos përfundimit. Sipërfaqja përfshin rreth 26.000 ha, të ndarë në 8 komuna.

Konsolidimet vullnetare të tokave (KVT). *Konsolidimet* e tokave që do të zhvillohen së fundi dhe të kryhen me iniciativë të pronarëve të tokave, komunave dhe ministrisë dhe që bazohen vetëm në pjesëmarrje vullnetare të pronarëve të tokave. Konsolidimi i tokave si instrument për të realizuar intervenimet publike dhe për t'iu zvogëluar dëmin pronarëve të tokave, i paraparë në Strategji si një prej pesë llojeve të konsolidimit të tokave, është i pranueshëm si koncept në Kosovë, por nuk është pjesë e përpjekjeve të tanishme. Megjithatë, ai do të mund të bëhet i rëndësishëm, në të ardhmen në kontekst të ndërtimit të magjistrales/autostradës së re. Konsolidimi i tokave atëherë do të jetë në kuadër të mandatit ligjor të projektit të magjistrales dhe për këtë arsye nuk është përfshirë në Plan-Veprim dhe Buxhet.

Momentalisht legjislacioni për rregullim të tokave nuk përputhet. Ligji për Komasacion të Tokës (LpKT), i viti 1987, “Gazeta Zyrtare KSA, Nr. 31/87” bazohet në pjesëmarrje të detyrueshme në projektet e konsolidimit të tokës në rastin kur 50% e pronarëve votojnë në favor të projektit të

konsolidimit të tokës. Në bazë të dispozitave të këtij ligji janë zhvilluar projektet e komasacionit në vitet e 80-ta. Tani është në fuqi Ligji për Tokë Bujqësore (LpTB 2006), i cili përcakton procedurat e rregullimit të tokave në Kapitullin 4 të tij. Për të filluar një projekt të konsolidimit të tokës, LpTB kërkon pëlqimin e 2/3 të pronarëve të tokave brenda masës së rregullimit. Pjesëmarrja reale në implementim do të bazohet plotësisht në pjesëmarrje vullnetare të të gjithë pjesëmarrësve.

MBPZHR-ja, e mbështetur nga projekti i BE “Mbështetje e Mëtutjeshme Shfrytëzimit të Tokave” aktualisht është duke hartuar draftin e Ligjit të ri për Rregullimin e Tokave (LpRT), i cili do të bazohet në principet vullnetare të pjesëmarrjes së pronarëve në projektet e konsolidimit të tokës. Një kapitull i këtij draft ligji do të sqaroj procedurat për përfundimin e komasacionit të papërfunduar të realizuar gjatë viteve të 80-ta.

Në maj 2010 MBPZHR ka vendosur që Strategjia të jetë dokument vendimtar i politikës. Pasi ky dokument ndjek filozofinë e rregullimit vullnetar të tokës, LpKT i vitit 1987, tani po riformulohet ashtu që elementet e detyrueshme të largohen. Mirëpo, rregullimet e papërfunduara të tokave janë bërë sipas ligjit të vitit 1987 dhe kërkon pjesëmarrje të të gjithë pronarëve të tokave brenda bllokut përkatës. Për atë arsye, kapitulli do të përfshihet në draft ligjin për rregullimin e Tokës, i cili përfshin kërkesat e veçanta të këtij lloji të rregullimit të tokave.

MBPZHR ka shpallur rregullimin e tokave si njërin nga prioritetet kryesore të politikave të saj. Në vitin 2008, MBPZHR ka filluar në Gjakovë, Prizren dhe Rahovec me Projektin “Shërbimet e Rregullimit të Papërfunduar të Tokave” dhe në vitin 2009 dhe 2010 ka vazhduar me punët në Vushtrri dhe Obiliq. Punët në Rahovec dhe Prizren ende nuk janë përfunduar, janë duke u zhvilluar përpjekjet për regjistrim të lendeve në RDPP.

3. RREGULLIMI I PAPËRFUNDUAR I TOKAVE

Punët e mëparshme

Në vitin 2008, kishte filluar përfundimi i konsolidimit të papërfunduar të tokave me 17 Zona Kadastrale (ZK) në komunat e Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit. Punët përbëheshin nga dy elemente themelore (i) regjistrimi i vendimeve “të vjetra” të viteve 1983-1989 në RDPP dhe (ii) azhurnimi i RDPP-së sipas të gjitha ndryshimeve të bëra ndërmjet vendimit dhe gjendjes (2008) së fundit. Derisa në Gjakovë ai ka përfunduar i tëri në mënyrë të kënaqshme në komunat Rahovec dhe Prizren një numër i vogël i lëndëve është regjistruar në RDPP, ndërsa për regjistrim të lëndëve të mbetura duhet ende angazhim dhe mbështetje për zyrtarët e zyrave të kadastrave të këtyre komunave.

Në vitet 2009-2010, është duke u realizuar projekti “Shërbimet e Komasacionit të Papërfunduar” në komunat Vushtrri dhe Obiliq. Projekti është duke u zbatuar sipas dinamikës së paraparë, termave të referencës së projektit dhe legjislacionit në fuqi. Realizimi i projektit është duke shkuar shumë më mirë se në përpjekjet e para gjatë vitit 2008. Janë marrë shumë parasysh përvojat nga përpjekjet e para.

Gjatë realizimit të projekt ALUP, është bërë regjistrimi i shtrirjes së problemit të RPT (Shkresa Teknike 23 ALUP, Qershor 2007). Ky regjistrim ofron informata të rëndësishme për përgatitjen e Plan Veprimit aktual. Përveç kësaj, raporti “Përmbledhja e aktiviteteve dhe detyrave të Akterëve në konsolidimet të pa përfunduar të Tokave.(MBPZHR,Mars 2009) duhet të përmendet si udhëzues i shkëlqyeshëm për realizim hap pas hapi të RPT. Ky udhëzues është miratuar si bazë për punët si të MBPZHR-së, ashtu edhe të KKRT, kontraktuesit implementues dhe kontraktuesit mbikëqyrës.

Regjistrimi i nevojave

Shtojca 1 paraqet statusin e të gjitha zonave kadastrale në 8 komuna të cilat ende merren me problemin e RPT-ve. Lista përfshin të gjitha 98 ZK-të ende të pazgjidhura në fillim të vitit 2008, mu para se të fillonte programi i rregullimit të tokave. Në verë të vitit 2010 u vizituan të gjitha komunat e interesuara për të siguruar azhurnimin e këtij regjistrimit të vitit 2007 dhe për të mbledhur informata shtesë. Shtojca 1 përfshin statusin e ZK-ve. Ky status klasifikohet në të përfunduar, pjesërisht të përfunduar, në zhvillim dhe ende të pa trajtuara.

Të përfunduara

ZK konsiderohet i përfunduar vetëm nëse Vendimet e Komisioneve Komunale të Rregullimit të Tokave (KKRT) 1983-89 janë regjistruar në RDPP dhe nëse regjistrimi është azhurnuar deri në gjendjen e tanishme.

Janë 6 ZK të tilla të përfunduara, të gjitha në Gjakovë.

Pjesërisht të përfunduara

ZK-të pjesërisht të përfunduara përfshijnë qoftë (i) ZK-të ku është regjistruar vendimi i vjetër në kuadër të programit të AKK-së 2003/2004 ose (ii) ZK-të të cilat i ka implementuar kontraktuesi në vitin 2008 dhe nuk janë përfunduar ende krejtësisht. Do të thotë se në ZKK-të duhet të behet regjistrimi i lendeve në RDPP.

Ekzistojnë 11 ZK të tilla pjesërisht të përfunduara, 5 në Rahovec dhe 6 në Prizren.

Të pa trajtuara

Kjo kategori përfshin ZK-të e trajtuara në programin 2009/2010, por ende është në zhvillim dhe ende nuk kanë filluar të gjitha ZK-të. Janë 79 ZK të tilla, prej të cilave 17 janë duke u implementuar në Vushtri.

Përveç kësaj, është vlerësuar edhe shkalla e ndërlikueshmërisë për të zgjedhur KPT-të dhe këto shkallë ndryshojnë në 5 klasa prej “Mirë” në “Të papërshtatshëm për implementim” Kriteret e rëndësishme për pozicionim janë:

- (i) shkalla e të pajtuarit për konsolidim të tokave siç është implementuar në vitet e 1980-ta,
- (ii) vështirësitë e veçanta që priten dhe
- (iii) vlerësimi subjektiv i shkallës së ndërlikueshmërisë nga ana e ZKK-ve

Nëse pëlqimi për rregullim të tokave është më i ulët se 40 %, përfundimi i RPT-së konsiderohet i pazbatueshëm (implementimi do të jetë gjithashtu i padëshirueshëm për shkak të konflikteve që priten. Për këtë arsye, së paku 9 ZK përjashtohen nga implementimi i përfundimit, sepse parcelizimi i tanishëm fare nuk ndjek rregullimin e tokave siç është projektuar në vitet e 1980-ta. Këshillohet që regjistrimi të jetë si në kohën e para-rregullimit të tokave, me azhurnim të mundshëm deri në vitin 2010. Mirëpo, në të gjitha rastet e të pajtuarit, do të nevojitet studim më i hollësishëm për më pak se 70% për të arritur tek një vendim i volitshëm nëse do të përfshihet ose jo ZK përkatëse në program.

Kriteret e buxhetit

Për projektim të programit afatgjatë, janë vlerësuar kriteret e buxhetimit në bazë të ndërlikueshmërisë së punëve që do të kryhen. Shumat janë parashikuar në bazë të punëve të përfunduara/në zhvillim e sipër. Veçohen katër kategori të shpenzimeve:

Kategoria	Përshkrimi	Shpenzimet e
-----------	------------	--------------

			vlerësuar/ha
1	Azhurnimi	Vendimet 183/89 e regjistruara sipas programit të AKK 2003/4	€ 170/ha
2	Regjistrimi në RDPP	Regjistrimi i pronarëve në RDPP nga projekti i MBPZHR 2008	€ 10/ha
3	Mirë	Nevojitet regjistrimi i vendimeve të vjetra dhe azhurnimi. Nuk priten probleme të veçanta.	€ 190/ha
4	Ndërlikuar	Problematik dhe shumë i ulët zbatimi i konsolidimit të tokave.	€ 210/ha
5	Pak pronarë	Pak pronarë për shkak të pranisë së NSH. Mirëpo, nuk është medoemos e lehtë.	€ 100/ha
6	ZC të prekura nga lumi Drenica	Është paraparë edhe rregullimi i rrjedhës së lumit Drenica që përshkon 10 zona kadastrale	€ 450/ha

Shpenzimet/ha e mësipërme janë ende pa harxhimet për mbikëqyrje. Për këtë qëllim parashikohet një shtesë prej 10 %, qoftë për vendosje të Komisionit të Rregullimit të Tokave në MBPZHR, të cilin do ta përbëjnë ekspertë të kontraktuar me tarifa të tregut, ose për kontraktimin e Kompanisë Mbikëqyrëse (të nivelit më të lartë).

Rastet e veçanta

Rastet e veçanta në vijim duhet të përmenden ndarazi.

1. Drenas/Glllogoc

Në komunën e Glllogocit, masa e rregullimit të tokave është ndarë nga lumi Drenicë. Dhjetë prej 21 ZK në RPT kufizohen me lumin. Njëkohësisht me përpilimin e planit për ri-radhitje të rregullimit të tokave, është planifikuar ri-radhitja e Drenicës, me qëllim të uljes së rrezikut nga përmytjet në Drenas. Kjo ri-radhitje nuk është bërë kurrë dhe rrjedha e lumit është ende e pandryshuar. Mirëpo, shpërndarja e rregullimit të tokave akordohet me ri-radhitje dhe duhet të merret parasysh programi për përfundim të këtyre ZK-ve. Shpenzimet për ri-radhitje janë përafërsisht € 700.000. Pranimi për rregullim të tokave është i lartë.

Opsionet janë:

- Implementimi i ri-radhitjes. Përparësia: nuk ka nevojë për ri-përpilim të planit për rregullim të tokave dhe ulja e përmytjeve. Mos-përparësia: I shtrenjtë dhe merr kohë.
- Radhitja të mbetet e pandryshuar. Përparësia: më pak shpenzime. Mos-përparësia: ri-projektimi i rregullimit gjithëpërfshirës të tokave, korrigjimi i vendimeve të viteve të 1980-ta dhe risistemimi i pronarëve të tokave në shkallë të gjerë. Nuk janë trajtuar rreziqet nga përmytjet.

Shënim: ka gjasa që të jetë i pashmangshëm korrigjimi i caktuar i planeve të vjetra për ri-radhitje, për shkak të kushteve fizike dhe për shkak ndryshimit të të menduarit që nga koha e projektimit si të vepohet me kanalizimin e lumit.

Pas disa shqyrtimeve të mëtutjeshme vendimin do ta marrin MBPZHR, MMPH dhe Komuna. Rekomandimi paraprak është që të kontrollohet, dhe nëse ka nevojë të përshtatet, projektimi i ri-radhitjes së lumit i para dy viteve dhe të zbatohet ri-radhitja një vit para fillimit të implementimit të KPT-së. Mjetet për ri-radhitjen e lumit duhet të gjenden përmes MMPH-së.

2. Rahovec dhe Gjakovë

Në Rahovec dhe Gjakovë janë raportuar ndryshime në drejtimin e lumenjve për shkak të rrjedhës natyrale. Duhet të bëhet një incizim për t'i vënë në hartë dhe për të caktuar sasinë e këtyre ndryshimeve. Nëse është e nevojshme, duhet të propozohen ndryshime përkatëse në vendimet e vjetra të KKRT-ve.

3. Gjakovë

ZK e Bërdosanes ka përfunduar në vitin 2009, si rrjedhojë e kontratës së vitit 2008 të Kontraktuesit "Geo Info". Punët si të tilla janë përfunduar dhe çështja e pagesës për punët e realizuara nga kompania "Geo-Info" mbetet të zgjidhen në të ardhmen në mes të palëve kontraktuese.

Orari i implementimit

Shtojca 2 jep orarin e propozuar të implementimit. Parimisht, ky orar mund të përpilohet në dy mënyra:

- *Serial dhe relativisht i përqendruar për komunë*

Komunat janë adresuar me radhë gjatë viteve, sidomos në fillim. Jo më shumë se një ose dy komuna janë adresuar në vit të caktuar.

Përparësia: është zvogëluar presioni për kapacitet të disponueshëm sa i përket kapacitetit implementues dhe është shfrytëzuar më mirë përvoja e korporatës e cila ekziston në Kosovë. Pritet që implementimi serial të zvogëlojë gjasat e problemeve të përballura në vitin 2008

Mos-përparësitë janë tendosje e madhe për ZKK-të dhe fakti se ka komuna që duhet të presin për shumë vite para se t'u vij radha që të trajtohen problemet e tyre me RPT-të.

- *Puna paralele në shumë komuna njëkohësisht dhe puna e shpërndarë me kohë.*

Parimisht, punët kanë filluar në të gjitha ose së paku shumicën e komunave njëkohësisht. Përparësia: të gjitha komunat angazhohen që nga fillimi, duke iu ofruar ndjenjën se problemet e tyre do të trajtohen. ZKK-të do të kenë më pak presion për shkak të vëllimit të ulët të regjistrimit në RDPP.

Mos përparësi është tendosja shumë e madhe e MBPZHR-së për të drejtuar një program të tillë. Përveç kësaj, medoemos do të kufizohet situata ku shumë kontraktues (kryesisht të papërvojë) dhe KKRT-të fillojnë në të njëjtën kohë, duke mbështetur në mënyrë të duhur KKT-të dhe duke kontrolluar kontraktuesit.

Në përgjithësi, opsioni është buxhet-neutral, edhe pse buxheti mund të ndryshoj për vit.

Përparësi e madhe i jepet qasjes seriale (opsioni i parë) për të lehtësuar presionin e kapacitetit të implementimit dhe kapacitetit mbikëqyrës, të cilët konsiderohen mu tani të jenë dobësitë më të rëndësishme në kapacitetin në Kosovë për të zhvilluar rregullimin e tokave.

Përveç kësaj, në vitet e para planifikohet RT më i thjeshtë, për të trajtuar rastet më komplekse më vonë me përvojë të përmirësuar dhe aftësi për zgjidhje të problemeve.

Orari është përpiluar duke pasur parasysh si vijon.

1. Pengesa

Faktori më shtrëngues për rregullim të tokave në Kosovë duhet të konsiderohet të jetë kapaciteti i ulët implementues në MBPZHR, ZKK dhe kompanitë kontraktuese për implementim. Kjo është përvojë e qartë e disa viteve të kaluara.

MBPZHR nuk ka përvojë dhe personel punëtorësh për t'u marrë me më shumë se një ose më së tepërmi dy kontrata kryesore të rregullimit të tokave në vit. ZKK-të po punojnë shumë që punët e përfunduara të regjistrohen në RDPP, por duke pasur parasysh vëllimin e punës, po ka vonesa të mëdha. Pastaj, momentalisht vetëm një Kontraktues implementues mund t'i kryej këto punë si duhet. Përveç kësaj, deri më tani vetëm një kompani mund të bëjë udhëheqje dhe mbikëqyrje të drejtë.

Megjithëse, si rezultat i programit, mund të pritët që me kalimin e viteve përvoja të shtohet dhe kapaciteti të përmirësohet. Orari duhet t'i përshtatët këtij shtimi të ngadalshëm të kapacitetit. Kjo nënkupton fillim relativisht modest dhe prodhimtari të shtuar me vite.

1. Stimulimi për shtim të kapacitetit dhe aftësive

Vëllimi vjetor i punëve duhet të zgjidhet ashtu që të jetë e mundur që ato të kryhen dhe të jenë në përputhje me orarin. Do të thotë se vëllimi i përgjithshëm i punëve do të mund të shtohet gradualisht me kalimin e viteve, duke pasur parasysh shtimin e kapacitetit dhe aftësive për organizim dhe implementim. Krijimi i kapacitetit shtesë duhet të vazhdohet me trajnimin e stafit të KKT-ve, ZKK-ve dhe MBPZHR-së, por edhe me shtimin e aftësive të firmave implementuese dhe mbikëqyrëse. Duhet t'u jepet rasti kompanive tjera implementuese dhe mbikëqyrëse në bazë të cilësisë të cilën mund ta ofrojnë. Kjo do të mund të bëhet me stimulimin e formimit të konsorciumit i cili përfshin si përvojën, ashtu edhe të porsaardhurit në treg.

2. Zyra e Rregullimit të Tokave (ZRT)

Është qenësore prania e njësisë shumë të kualifikuar teknike e cila bën tenderimin dhe mbikëqyrjen e punëve. Kjo mund të arrihet me vendosjen e ZRT të kontraktuar ose me caktimin e Firmës Mbikëqyrëse. Është qenësore që realizueshmëria e kësaj njësie ose firme të jetë e cilësisë së lartë. Nëse ky kusht nuk përmbushet, ka gjasa që punët të dështojnë.

3. Kriteret e përzgjedhjes

Kriteret e përzgjedhjes së tenderit duhet të kenë parasysh njëkohësisht cilësinë dhe çmimin, e jo vetëm çmimin. Puna e vështirë dhe tepër e ndjeshme e rregullimit të tokave nuk ndihmohet me kontraktues me çmim shumë të lartë të cilët nuk e njohin (sa duhet) mjeshtërinë e rregullimit të tokave dhe nuk janë shumë të sigurtë në kryerjen e punëve në përputhje me kërkesa dhe specifikacione të cilësisë.

4. Buxheti

Buxheti maksimal vjetor të cilin e ka vënë në dispozicion QeK është marrë si € 700.000. Kjo shumë është arritur në diskutime me Dept. e Zhvillimit Rural. Shpenzimet vjetore duhet të mbesin nën këtë kufi. Plani paraqet se buxheti nuk është pengesë kryesore e programit.

5. Viti financiar.

Sa i përket rregullave mbizotëruese financiare, implementimi duhet të organizohet ashtu që ai të mund të përfundohet në të njëjtin vit financiar, duke zvogëluar presionin e mirënjohur në fund të vitit për të bërë pagesën e parakohshme minimale të kontraktuesve.

6. Azhurnimi i planit të aktiviteteve shumëvjeçare.

Plani i prezantuar në Shtojcën 2 nuk duhet të konsiderohet i ngurtë. Rrethanat vendore sipas zhvillimit dhe ndryshimit me kohë, mund të paraqesin arsye të mira për përshtatje të prioriteteve dhe radhitje të implementimit. Të pandara në këtë punë janë edhe vështirësitë dhe vonesat e papritura dhe mund të japin arsye për azhurnim të planit. Prandaj, është e dëshirueshme që plani të azhurnohet në bazë vjetore. Kjo mund të bëhet më së miri verës, me qëllim që me kohë të bëhen kërkesat për buxhet të vitit të ardhshëm.

Procedura e hollësishme që do të ndiqet në rregullimin e papërfunduar të tokave është dhënë në Udhëzuesit e MBPZHR-së "Përmbledhja e Aktiviteteve e Rregullimet e pa Papërfunduara të Tokave në Kosovë", MBPZHR,(Mars 2009).

Në buxhet është paraparë ndihmë e veçantë ZKK-ve të komunave në Rregullimet e Papërfunduara të Tokave. Përvoja në Prizren, Rahovec, Gjakovë dhe Vushtrri na mëson se regjistrimi në RDPP i sasisë së madhe të të dhënave – posa ato të arrijnë me përfundimin e RPT-ve – është shumë larg kapacitetit njerëzor dhe financiar të ZKK-ve. Kjo rezulton në vonesa serioze në regjistrim dhe në disa raste (Rahovec dhe Prizren) edhe në pushimin e këtyre punëve. Nuk mund të lejohet vazhdimi i kësaj gjendjeje, sepse do të mund të shkaktoj dështimin e programit të RPT.

Prandaj Plan-veprimi cakton mjete për mbështetje të ZKK-ve për ta paguar stafin përgjegjës permanent të ZKK-ve për punë pas orarit dhe të cilët pranojnë të bëjnë regjistrim të tillë.

4. RREGULLIMET VULLNETARE TË TOKËS

Konceptet e rregullimit vullnetar të tokave janë krijuar gjatë Projektit për shfrytëzimin e Tokave Bujqësore (ALUP) dhe viteve pasuese gjë që ka rezultuar në aprovimin e Strategjisë. Zbatimi i këtyre koncepteve duhet të realizohet në Kosovë gjatë dhjetëvjeçarit të ardhshëm.

Zgjidhja e rregullimit të papërfunduar të tokave – megjithëse me probleme dhe i vështirë për t'u trajtuar dhe megjithëse është qartë prioritet i parë i MBPZHR-së –duhet të konsiderohet si karakteristik për tërë objektivin e çështjes së përmirësimit të strukturës së fermës dhe synimit për të shtuar realizueshmërinë e bujqësisë në Kosovë. Për të përmirësuar strukturën bujqësore, QeK ka zgjidhur rregullimin vullnetar të tokave si njërin nga instrumentet e disponueshme për ta arritur këtë. Kjo është parashtruar në Strategji dhe legjislacionin përkatës.

Rregullimi vullnetar i tokave është proces i ngadalshëm dhe projektet nuk do të finalizohen vetëm brenda një viti (financiar). Buxhetet e projektit duhet të zëbrthehen në pjesë të veçanta dhe të garantohet se mjetet do të vihen në dispozicion gjatë vitit të ardhshëm financiar për fazën e ardhshme të projektit të veçantë. Përveç kësaj, dihet se vonesat në zhvillimin dhe implementimin e projekteve janë më tepër rregull se përjashtim. Do të thotë se duhet të bëhen përgatitjet me MEF-in për të siguruar përfundimin e pjesëve të projektit njëvjeçar, nëse kjo duhet të bëhet në vitin që pason.

Strategjia përshkruan procedurën e rregullimit vullnetar të tokave. Procedura është përmbledhur në Shtojcën 3.

Koncepti i RVT ende nuk është vendosur fuqimisht në Kosovë. Për atë arsye, MBPZHR-ja do të bëjë sensibilizimin për mundësitë e RVT-së, përfitimeve, procedurave, sigurive dhe përfitimeve që do të realizohen. Kjo do të bëhet përmes fushatave të sensibilizimit. Në këtë MBPZHR do të jetë udhëheqëse dhe në mënyrë pro-aktive do të identifikoj dhe do të kontaktoj grupet fermere dhe komunat që mund të jenë të interesuara. Mjetet vjetore do të përfshihen në Buxhet.

Programi i RVT do të angazhohet t'iu jep pjesëmarrësve potencial dobisë e qarta, përfshirë shpenzimet e transaksionit pa pagesë, si dhe elemente të caktuara ndërtimore, posaçërisht qasjen e rrugëve në ferma, dhe nëse është e përshtatshme, përshtatjen dhe rehabilitimin e sistemit të ujitjes.

Opsionet e qiradhënies së tokës në vend të këmbimit të pronës së tokës, mund të lehtësojnë vendim marrjen dhe hapin mundësitë në projekt, të cilat përndryshe mund të mbeten të mbyllura. Në kuadër të RVT-së, qiradhënia duhet që të formalizohet së paku në afat të mesëm (jo më të shkurtër se 7 vjet) dhe të futet në kadastër.

Ende nuk ka aq shumë përvojë me buxhetet e nevojshme për Rregullim Vullnetar të Tokave. Gjithashtu këtu do të përvetësohet çmimi për ha për qëllime planifikimi. RVT i parë i cili në të vërtetë do të implementohet do të jep informata më të hollësishme.

Çmimi për € 500/ha do të merret derisa të dihet më shumë rreth shpenzimeve reale. Ky çmim përfshin:

- Përgatitjen e skicës
- Inçizimet themelore, përfshirë intervistat me pronarët dhe sqarimi i pronësisë
- Planin projektues
- Sqarimin e çështjeve të pronësisë përmes çështjeve të trashëgimisë dhe transaksioneve
- Sqarimin e çështjeve të hipotekës (nëse ka)
- Vlerësimin relativ, nëse ka nevojë
- Propozimin për qasje rrugore

- Të gjitha incizimet e nevojshme gjeodezike
- Propozimin për vendim dhe vendim përfundimtar të KKRT-së
- Përgatitjen për regjistrim në ZKK
- Shpenzimet e transaksionit

Në Kapitullin 6 është dhënë buxheti i përgjithshëm. Hollësitë mbi RPT janë përfshirë në Shtojcën 2.

Buxheti i veçantë është përmirësimi i qasjes fizike. Shpenzimet e rrugëve anësore është llogaritur të jenë për 300 m në 1 km për RVT dhe janë llogaritur € 2000 / 100 m gjatësi të rrugës. Gjatësitë dhe buxheti i llogaritur janë të përkohshëm dhe duhet të përshtaten posa të ketë më shumë informacione në dispozicion pasi të ketë përfunduar RPT-ja e parë. Gjatësia e llogaritur e 300m për RVT vlen për skemat e vogla deri në 30 ha dhe gjatësia e llogaritur prej 1 km për RPT vlen për skemat më të mëdha se 30 ha.

Kompensimet për KKRT janë buxhetuar ndarazi, si për RPT, ashtu edhe për RVT.

Nuk janë buxhetuar punët e përshtatjes së parcelave. Punët për përshtatjen e parcelave kanë të bëjnë me përshtatje të vogla të cilat do të bëhen në parcela të këmbëyer, për t'i bërë ato të përshtatshme për shfrytëzim për pronarin e ri. Punët e tilla nevojiten shpesh për të lehtësuar këmbimin e parcelave. Pritet që sipërfaqet të jenë të jenë të vogla. Gjatë KVT-së së parë do të fitohet përvoja për nevojat dhe nëse ka nevojë, do të merren mjete nga disa pjesë tjera të buxhetit.

Ku është e përshtatshme, RVT do të kombinohet me programin e rehabilitimi të ujitjes të MBPZHR-së.

Është e vështirë të planifikohen rregullimet vullnetare të tokave, sepse ato bëhen me kërkesë. Propozohet që në 10 vitet e ardhshme që me fushata të sensibilizimit të provohet dhe të shtohet njohuria dhe interesimi në mes të fermerëve dhe buxheti të bazohet në kërkesë të shtuar ngadalë. Në vitet e para, numri i RVT-ve do të jetë i ulët dhe gjithashtu ato do të jenë të vogla për nga madhësia. Pritet gjithashtu që me vite të shtohet edhe madhësia sa i përket sipërfaqeve në ha dhe numrit të pjesëmarrësve.

Pritet që për ta përfunduar RVT-në do të nevojiten dy vite. Viti i 1^{ri} do të plotësohet me informimin e fermerëve, sqarimin e pronësive, vendim marrje dhe negociata. Viti i 2^{ti} do të shkojë në përgatitjen e planit, këmbimin aktual të tokave dhe regjistrimin e pronave të reja. Duhet pasur parasysh se kjo periudhë kohore do të nevojitet të vazhdohet në shumë raste.

5. PËRGATITJET QË DO TË BËHEN DHE VEPRIMET QË DO TË NDËRMIRREN

- Caktimi i mandateve të qarta për rregullim të tokave në MBPZHR, përfshirë Drejtorin e DZHR, Shefin e Prokurimit, Komisionin Mbikëqyrës të Rregullimit të Tokave dhe Sekretarin e Përhershëm.
- Në rend të parë është mandati i duhur ligjor i KKRT-ve. Këto mandate duhet t'i sigurojë Ligji i ri për Rregullimin e Tokave (LpRT).
- Formimi (nëse ende nuk është bërë) dhe trajnimi iu KKRT-ve, duke i njoftuar ata me detyrat e tyre para kontraktimit të rregullimit të tokave.
- Nevojiten trajnime dhe asistencë ZKK-ve për të aftësuar stafin të merret me numër të madh regjistrimesh. Këshillimi me AKK-në për këtë çështje. Të përfshihen në mjetet e buxhetit për Rregullimin e Tokave për të asistuar ZKK-të në kryerjen e regjistrimit të rregullimit të papërfunduar të tokave.
- Në secilin rast të RPT dhe RVT, të bihet në ujdi me procedurën e regjistrimit në Gjykatën Komunale, ZKK dhe AKK.

- Janë qenësore kompensimet adekuate anëtarëve të ZKK për t'i motivuar. Puna e ZKK-së është e madhe dhe duhet të kryhet kryesisht në kohën personale të anëtarëve. Mu tani, anëtarët e KKRT-ve e ndjejnë këtë aktivitet si ngarkesë të punës shtesë për të cilën ata nuk kompensohen.
- Duhet të vihen në dispozicion mjete dhe duhet të ketë tenderë në qarkullim në muajin nëntor dhe dhjetor të vitit paraprak, duke lënë kohë të mjaftueshme për përfundimin e punëve gjatë vitit kalendarik.
- Përgatitjet brenda MBPZHR dhe MEF për të mundësuar projektet shumëvjeçare të rregullimit vullnetar të tokave dhe për të llogaritur vonesat në implementim.
- Fushata e sensibilizimit në rregullimin vullnetar të tokave si aksion përgatitor për nismën e rregullimit vullnetar të tokave.
- Përpilimi i kontratës së standardizuar por të përshtatshme në mes të MBPZHR-së dhe kontraktuesve të saj (Gjedoeti dhe Firma Mbikëqyrëse), e cila specifikon kërkesat e planifikimit, detyrat e hollësishme, produkti që do të dorëzohet, procedurat që do të ndiqen, të përmbajturit e Specifikacioneve Teknike dhe procedurat e pagesës. Specifikacionet Teknike do t'i shtohen kontratës si Shtojcë.
- Me MM-të do të merret MBPZHR-ja dhe Komunitatet përkatëse (të dyja në rast të RPT, si dhe RVT).

- Këshillimi me Ministrinë e Transportit dhe Komunitet përkatës, në qoftë se rregullimi i tokave do të mund të luaj rol në minimizimin e dëmtimit të pronarëve të tokave në rast të projekteve të mëdha infrastrukturale.

6. BUXHETI.

Më poshtë është dhënë buxheti i përgjithshëm vjetor. Buxheti dhe planifikimi duhet të përshtaten çdo vit në pajtim me trendet, progresin, njohurinë e shtuar dhe zhvillimet e papritura.

Asistenca ZKK-ve për regjistrim në RDPP do të përmbledhet në subvencion vjetor për të paguar tre anëtarë stafi të ZKK-ve për punën jashtë orarit ku është në zhvillim e sipër RPT-ja në atë vit të caktuar. Kjo punë përtej orarit të punës do të ndryshoj nga vëllimi i punës së kryer. Vëllimi varet nga sasia e punës së kryer. Pagesa nuk bazohet në kohën e shpenzuar, por në vëllimin e punës së kryer.

Buxheti i nevojshëm për pagesa jashtë orarit të punës bazohet në pikat vijuese të nismës:

- Punonjësi i kualifikuar i ZKK që ngarkohet me regjistrimin në RDPP mund të kryej 15 pronarë për ditë pune,
- Është paraparë pagesa prej € 2,- për pronar të regjistruar.
- Në rastin e 4 ZK-ve të regjistruara, koha e shpenzuar për rreth 2 muaj pune të punës jashtë orarit në vit nga ana e 3 punonjësve

Duhet kuptuar se llogaritjet janë vlerësime. Për më tepër, shumat janë të vogla, krahasuar me shumat e nevojshme për punët aktuale.

Shumat në buxhetin e mëposhtëm i referohen Rregullimeve të Papërfunduara të Tokave dhe ato janë vlerësimet e sasisë së punës që do të kryhet në vit. Në fillim të çdo viti, duhet të bëhet një vlerësim i vullnetar se si të ndahen subvencionet e disponueshme për atë vit. Rregullimet Vullnetare të Tokave pritet të jenë relativisht të pakta në numër në vitet e ardhshme, këtu nuk janë paraparë kurrfarë subvencione.

Nuk është përfshirë kurrfarë mase për inflacion dhe ndryshim të shkallës së çmimit.

Buxheti për Rregullimin e Tokave 2010-2020

Viti	Rregullimi i Papërfunduar i Tokave (RPT)						Rregullimet Vullnetare të tokave (RVT)					Trajnimi KKRT	Sensibilizi mi	Totali i përgjithshëm
	Nr i ZK	Sip. (ha)	KKRT	KMP	KIP	Shuma e përgj (€)	Sipërfaqe në akra në RVT (ha)	Çmimi i njësisë /ha (€)	Qasja rrugore (€)	KKRT+KM P (€)	Shuma e përgj. (€)	€	€	€
2011	20	5,529	30,240	47,500	504,580	582,320	60	500	12,000	6,000	48,000	2,000	15,000	647,320
2012	11	2,487	34,560	47,000	470,950	552,510	60	500	12,000	6,000	48,000	2,000	15,000	617,510
2013	9	1,946	33,120	37,500	373,860	444,480	60	500	12,000	6,000	48,000	2,000	10,000	504,480
2014	7	2,067	24,520	39,000	392,730	456,250	60	500	12,000	6,000	48,000	2,000	10,000	516,250
2015	6	1,842	12,960	35,000	349,980	397,940	80	500	16,000	8,000	64,000	2,000	10,000	473,940
2016	5	1,400	17,280	48,000	484,920	550,200	80	500	16,000	8,000	64,000	2,000	10,000	626,200
2017	5	1,527	17,280	53,000	537,870	608,150	100	500	20,000	9,000	79,000	2,000	10,000	699,150
2018	4	1,614	8,640	47,000	472,240	527,880	100	500	20,000	9,000	79,000	2,000	10,000	618,880
2019	4	2,701	8,640	37,500	375,450	421,590	150	500	30,000	12,000	117,000	2,000	10,000	550,590
Totali	71	21,113	187,240	391,500	3,829,230	4,541,320	750	500	150,000	53,000	595,000	18,000	100,000	5,254,320

Supozimet dhe llogaritjet:

- Hollësitë për RPT në Shtojcën 2
- KKRT është aktiv në RPT për rreth 10 ditë në muaj
- KKRT është aktiv në RVT për rreth 5 ditë në muaj
- Mëditja për anëtarë të KKRT është € 20,-
- Nuk është i sigurt vëllimi i RVT.
- Qasja rrugore: shpenzimi: € 2,000 / 100 m.

SHTOJCA 1

**Lista e Zonave Kadastrale
me
Rregullimet e Papërfunduara të Tokave
dhe
Statusi i tyre në Korrik 2010**

SHTOJCA 2

Ndarja e Propozuar e Punëve në Faza dhe Buxhetimi i Rregullimeve të Papërfunduara të Tokave

SHTOJCA 3

**Përmbledhja e Aktiviteteve dhe Detyrat e Akterëve
në
ne Rregullimet Vullnetare të Tokave.**

SHTOJCA 4

**Përmbledhja e Aktiviteteve dhe Detyrat e Akterëve
në
ne Rregullimet e pa Përfunduar të Tokave.**

